

Prishtinë, 25/10/2024

Komisioni i Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të FBK-së, nën suaza të mandatit që ushtron, në mbledhjen e mbajtur me datë 25.10.2024, në përbërje prej: Armend Hamiti kryetar i KG, Arianit Shala anëtar i KG dhe Ismet Ferati anëtar i KG shqyrtoi dhe miratoi këtë:

VENDIM NR. 20/2024/25 I KOMISIONIT TË GARAVE

- I. Komisioni i Garave ka shqyrtuar kërkesën e paraqitur nga KBF Prishtina për regjistrimin e lojtares Besjana Martinaj si lojtar të lirë (free agent)¹ jashtë afatit kalimtar.
- II. Komisioni i garave pas shqyrtimit të kësaj kërkesë e bazuar në Rregulloren për regjistrim dhe kalim të FBK-ës 2024/2025, MIRATON kërkesën e KBF Prishtina.
- III. Vendimi hyn në fuqi nga data e publikimit

ARSYETIM

Gjatë vendimmarrjes lidhur me Vendimin Nr. 20/2024-25, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

- (a) KBF Prishtina ka paraqit kërkesë për regjistrimin e lojtares Besjana Martinaj si **lojtar të lirë (free agent) jashtë afatit kalimtar.**

¹ **Lojtar i lirë (free agent)** – lojtar të cilit i ka përfunduar kontrata me ekipin e tij të mëparshëm (nuk ka kontratë aktive/valide) dhe është i lirë të nënshkruajë një kontratë të re me cilindo ekip tjetër. Një lojtar i lirë ka të drejtë të negociojë dhe të pranojë oferta nga ekipet e tjera pa kufizime të vendosura nga ekipi i tij i mëparshëm.



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT




FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com Lagjja "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000 Prishtina

- (b) Lidhur me kërkesën e KBF Prishtina, nga shkresat e prezantuara shihet se e njëjta e ka statusin e lojtarit të lirë, andaj në përputhje me nenin 14 pika 4.7 në Rregulloren për regjistrim dhe kalim të FBK-ës 2024/2025, u miratua ky regjistrim i lojtares Besjana Martinaj.

Në emër të Komisionit të Garave të FBK-së,

Armend **HAMITI**
Kryetar i Komisionit



Federata e Basketbollit të Kosovës

KËSHILLË JURIDIKE:

Në pajtim me *Nenin 45 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, Edicioni 2024/2025, në vendimin e Komisionit të Garave është e lejuar ankesa tek Komisioni i Arbitrazhit të FBK-së (si organ i shkallës së dytë), e cila dorëzohet më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit. Për ankesë, paraqitësi i ankesës duhet të deponojë në llogarinë e FBK-së shumën prej 500.00 €.*



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com Lagjja "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000 Prishtina